



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

AD/GJTHPE/.nr.4/23

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, me Kryetarin e Gjykatës Armend Berisha, në procedurën disiplinore ndaj gjyqtarit A.M, duke vepruar sipas ankesës disiplinore të parashtruar nga A.S, me banim në M., pas shikimit të shkresave dhe vlerësimit të ankesës, jashtë seancës, me datë 05.05.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET ankesa disiplinore e parashtruar nga A.S, me banim në M., ndaj gjyqtarit A.M, **SI E PABAZUAR.**

A r s y e t i m

Me datë 25.04.2023, konform nenit 9 par.5 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, Avokati i Popullit brenda afatit ligjor ka përcjellë te autoriteti kompetent ankesën disiplinore të parashtruar nga A.S, me banim në M., ndaj gjyqtarit A.M, me arsyetimin se ankesën e parashtron për të gjitha këqijat, shantazhet, dhunën dhe maltretimet që i ka shkaktuar Gjykata Themelore në Pejë – Dega në I. përkatësisht, gjyqtari A.M së bashku me Prokurorinë Themelore në Pejë dhe Policinë e I., për afër gjashtë vjet duke ja shkaktuar jetën dhe karrierën. Si provë ankesës së tij ia ka bashkëngjitur Aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Pejë PP/II.nr..../..., të datës 27.11.2017, të ngritur ndaj të akuzuarit A.S, për vepër penale nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar ose etnik nga neni 147 par.1 të KPRK-së, Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë – Dega në I. (gjyqtari P.N) P.nr..../..., të datës 19.12.2022 me të cilën është refuzuar aktakuza për shkak se prokurori i shtetit është tërheqë nga akuza në shqyrtim gjyqësor, Aktvendimet e Gjykatës Themelore në Pejë – Dega në I. (gjyqtari P.N) P.nr..../..., për caktimin dhe vazhdimin e masës së paraqitjes në Stacionin Policor, Urdhëresën për shpalljen e letër rreshtimit, të lëshuar nga Gjykata Themelore në Pejë – Dega në I. (gjyqtari A.M) P.nr..../..., të datës 20.03.2019, Raporte të Oficerit, Kërkesë e Prokurorisë Themelore në Pejë për lëshim të urdhër arrestit, Ankesën lidhur me lëndën P.nr..../... drejtuar Avokatit të Popullit me datë 07.04.2022, në të cilën ka theksuar se në vitin 2017 është arrestuar sipas një urdhërarresti dhe është marrë në pyetje duke u kërcënuar që të pranoj dhe të nënshkruaj pretendimet e prokurores dhe gjyqtarëve A.M dhe G.R edhe pse nuk e posedonte as aktakuzën dhe nuk e dinte për çfarë akuzohej dhe se aktakuza i është dhënë vetëm pasi është ankuar te Avokati i Popullit në vitin 2017 ndërsa, në vitin 2018 gjyqtari i ka thënë se “e sheh kur të del në gjyq sepse ti nuk po bashkëpunon me gjykatën”. Gjithashtu, parashtresës së tij ja ka bashkëngjitur si provë edhe një lutje të datës 14.10.2022 drejtuar Kryetarit të Gjykatës Themelore në Pejë për caktim më të shpejtë të seancës së shqyrtimit gjyqësor, në të cilën ka theksuar se ka qenë gjykatë me datë 21.12.2018 ku ka biseduar për çështjen e tij me gjyqtarin A.M, gjyqtarin G.R dhe një tjetri që nuk ia din emrin por, të njëjtit nuk ja kanë caktuar seancën gjyqësore ndërsa, në vitin 2020 ka angazhuar një avokat i cili i ka garantuar prezencën në seancë me para por, gjyqtari ka refuzuar duke shtuar po ashtu se

në atë kohë nuk ka pas mundësi të vie në Kosovë sepse vizën Austriake e kishte të pasigurte dhe me ardhjen e tij do t'a humbte vizën.

Me datë 25.04.2023, në kuptim të nenit 9 par.5 të Ligjit mbi Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, autoriteti kompetent e ka njoftuar Këshillin Gjyqësor të Kosovës për ankesën disiplinore të parashtruar ndaj gjyqtarit A.M.

Gjyqtari A.M, në deklaratën e tij të dhënë me shkrim lidhur me pretendimet e parashtruesit të ankesës ka theksuar se në Gjykatën Themelore në Pejë – Dega në I. ka qenë bartës i lëndës P.nr..../..., ndaj të pandehurit A.S, nga fshati C., Komuna I., i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë PP/II.nr..../..., të datës 27.11.2017, për vepër penale nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar ose etnik nga neni 147 par.1 të KPRK-së dhe i ka ndërmarrë të gjitha veprimet procedurale deri me datë 01.12.2021 kur është transferuar në Gjykatën Themelore në Pejë – Departamenti për të Mitur, të cilat veprime i ka ndërmarrë në përputhje të plotë me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, pa pas asnjë tendencë ndaj palëve në procedurë dhe në përpjekje për zgjidhjen e çështjes penale brenda afatit kohor sa më të shkurtër. Në kontekst të kronologjisë së rastit, gjyqtari ka sqaruar se pas pranimit të lëndës, me datë 19.09.2018 dhe me datë 05.12.2018 ka caktuar seancën fillestare por, në të dy rastet nuk ka marrë pjesë i pandehuri dhe fletëkthesa është kthyer me konstatimin se “pala gjendet jashtë shtetit” andaj, konform nenit 175 par.1 të KPPRK-së ndaj të pandehurit A.S ka lëshuar Urdhër arrest. Seanca e radhës e shqyrtimit fillestar është caktuar me datë 12.02.2019, në të cilën përsëri nuk ka qenë prezent i pandehuri ndaj të cilit ishte lëshuar Urdhërarrest dhe gjykata ishte njoftuar nga policia se i pandehuri A.S gjendet jashtë shtetit. Gjykata ka caktuar seancë fillestare edhe me datë 19.03.2019, në të cilën nuk ka prezantuar i pandehuri dhe meqë sipas informacioneve të pranuar nga policia, i pandehuri gjendet jashtë shtetit, ka lëshuar Letër rreshtim vendor ndërsa, tutje veprimet e tjera procedurale janë ndërmarrë nga gjyqtari që është ngarkuar me këtë lëndë, pas transferimit të tij në Gjykatën Themelore në Pejë andaj, vlerëson se edhe pretendimet në ankesë që kanë të bëjnë me veprimet procedurale të ndërmarra tutje nuk i atribuohen atij si gjyqtar dhe si të tilla nuk i përkasin që t'i komentoj apo sqaroj. Lidhur me pretendimet se ankuesi ka prezantuar në gjykatë me datë 21.12.2018, ku ka biseduar për datën e caktimit të seancës me gjyqtarët A.M dhe G.R, gjyqtari ka deklaruar se gjatë veprimtarisë së tij si gjyqtar gjithmonë seancat gjyqësore i ka caktuar sipas radhës së lëndëve e jo duke biseduar me palët ndërkaq, lidhur me pretendimin e ankuesit se nuk është pajisur me kohë me Aktakuzën ndaj tij dhe të njëjtën e ka pranuar pas paraqitjes së ankesës te Avokati i Popullit si dhe kinse ka pasur presion që “t'a pranoj fajësinë se kalon më lehtë”, gjyqtari theksoj se pas analizimit të kohës së paraqitjes së ankesës te Avokati i Popullit, me datë 18.04.2023 dhe Procesverbalit të seancës fillestare, të datës 08.09.2022, në të cilën i akuzuari ka deklaruar se me kohë e ka pranuar aktakuzën, deklarimi i tij bie në kundërshtim me pretendimet e tij. Sa i përket pretendimit se ka prezantuar në seancë para gjyqtarëve A.M, G.R dhe një gjyqtari tjetër dhe aty është zhvilluar një gjykim, gjyqtari theksoi se pretendimi i tillë është tërësisht i pabazuar, në radhë të parë për shkak se çështja penale në fjalë trajtohet nga gjyqtari i vetëm gjykues pastaj, nëse i pandehuri do të paraqitej në gjykatë nuk do të dështonin radhazi katër seanca të caktuara e aq më tepër, nuk do të ndërmerreshin veprimet procedurale siç janë lëshimi i urdhër arrestit dhe letër rreshtimit vendor e po ashtu, nëse do të mbahej gjykimi do të ekzistonte evidenca nga Procesverbalet. Andaj, vlerëson se të gjitha pretendimet e parashtruesit të ankesës janë të paargumentuara, duke shtuar po ashtu se gjykata nuk ka interes që çështjet e adresuara në gjykatë të zvarriten e as t'i trajtojë në aspekt personal, kështu që pretendimet e ankuesit duhet të trajtohen si të pabazuara pasi nga secili

dokument i gjykatës i prezantuar nga ai, vërtetohet vazhdimësia ligjore e procedurës së iniciuar ndaj tij.

Kryetari i Gjykatës duke vlerësuar ankesën e parashtruar si dhe deklaratën e gjyqtarit, ka gjetur se ankesa disiplinore ndaj gjyqtarit A.M, është e pabazuar.

Autoritetit kompetent vlerësoj të gjitha pretendimet e parashtruesit të ankesës dhe atë faktin se është marrë në pyetje duke u kërcënuar që ta pranoj fajësinë, se nuk e ka poseduar aktakuzën dhe nuk ka qenë në dijeni se për çfarë po gjykohet, se gjyqtari A.M i është drejtuar me fjalët “e sheh kur të del në gjyq..” dhe gjeti se të gjitha këto pretendime janë dukshëm joserioze, të paargumentuara në asnjë mënyrë dhe të pambështetura në asnjë provë, njëjloj siç nuk janë arsyetuar dhe argumentuar as thëniet e tij se ka qenë i shantazhuar, i dhunuar dhe i malltretuar nga gjyqtari në fjalë. Andaj, autoriteti kompetent gjen se vetëm parafrazimi i fjalëve të tilla, pa i argumentuar, është e pamjaftueshme për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit.

Në vlerësim të shkresave të lëndës autoriteti kompetent u bind se gjyqtari A.M, gjatë kohës sa ka qenë i ngarkuar me lëndën penale P.nr..../..., ndaj të pandehurit A.S, as që e ka pasur mundësinë të takohet me të pandehurin - këtu parashtruesin e ankesës, ngase në këtë çështje ka caktuar 4 herë radhazi seancë fillestare, në të cilat ka munguar i pandehuri - këtu parashtruesi i ankesës, prezenca e të cilit në gjykatë rezulton se nuk ka mundur të sigurohet për katër (4) vite sepse ka qenë i paarritshëm që nga viti 2018 deri me datë 08.09.2022, kur është arrestuar sipas Letër rreshtimit pra, i pandehuri për herë të parë është paraqitë në gjykatë për këtë çështje penale para gjyqtarit tjetër, e që nuk është gjyqtari A.M, për të cilin këtu parashtruesi i ankesës thekson se ka biseduar me të për çështjen e tij, e ka detyruar të nënshkruaj deklarata të paqena apo e ka marrë në pyetje duke e kërcënuar dhe i ka thënë se “e sheh kur të del në gjyq..” apo se e ka detyruar ta pranoj fajësinë. Rrjedhimisht, në veprimet e gjyqtarit A.M, të ndërmarra në çështjen penale ndaj të pandehurit A.S, këtu parashtruesit të ankesës, nuk gjeti asnjë element të shkeljeve disiplinore të etikës për gjyqtar andaj, në rrethana të tilla, Kryetari i Gjykatës si autoritet kompetent, gjeti se ankesa disiplinore është e pabazuar dhe si e tillë u refuzua.

Nga arsyet e theksuara me lartë, konform dispozitave ligjore të nenit 9 par.6 të Ligjit mbi përgjegjësitë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, dhe nenin 7 par.3 pika 3.1 dhe 3.2 të Rregullores të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nr.05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve u vendos si ne dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, AD/GJTHPE/.nr.4/23, me datë 05.05.2023.

**Kryetari i Gjykatës
Armend Berisha**

Vendimi i dorëzohet:

1. *Këshillit Gjyqësor të Kosovës*
2. *Gjyqtarit A.M*
3. *Parashtruesit të ankesës – A.S*
4. *Avokatit të Popullit*